



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 531/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Mitrovicë paraqitur kundër Blerta Hajra – Komisionere e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Mitrovicë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Mitrovicë, në të cilën ka pretenduar se me dt 03 Nëntor rreth orës 09.10, në shkollën Ismajl Qemajli në Mitrovicë QV 11042/05 rreth orës 13.00 vëzhguesi ynë ka vërejtur se numri i fletëvotimeve të përdorura nuk është në përputhje me numrin e votuesve që kanë votuar deri tash. Komisioneri ynë Ehad Damati është i bindur se këtë veprim e ka kryer Blerta Hajra komisionere nga PDK për shkak se e njëjta është vajza e Arbër Hajrës i cili është edhe staf i Komunës së Mitrovicës dhe janë mbështetës të partisë në pushtet dhe pretendon se e njëjta mund ti ketë dhënë dy fletëvotime një personi.

PZAP-I e informoi Komisionin Qëndror Zgjedhor (KQZ) në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më 05.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe eka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri me datë 07.11.2013, sipas afatit të caktuar, PZAP-I, pranoi përgjigjen e kërkuar nga Komisioni Qëndror Zgjedhor (KQZ), në të cilën theksohet se: Materiali zgjedhor është duke u proceduar sipas procedurave të brendshme të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe deri në përfundimin e këtij procesi nuk mund të vërtetohet saktësia e pretendimeve ankimore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-sw, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 531/2013 më datën 07.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**

Këshillë Juridike: *Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*